



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: __ Dhjetor 2020

Nr: -----

PROJEKTVENDIM

**PËR MIRATIMIN E MODELIT DHE SPECIFIKIMEVE TË KUTIVE TË VOTIMIT DHE
KUTIVE TË MATERIALEVE ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN NË ZGJEDHJET PËR
KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19 paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafin 2, nenin 99, paragrafi 1, shkronja “a”, nenin 99 paragrafi 2, shkronja “a”, nenin 100, paragrafi 1, shkronja “a” dhe “b” dhe nenin 104, paragrafi 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi propozimet dhe dokumentacionin e paraqitur;

V Ë R E N:

Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 99, përcakton detyrimin e KQZ-së për dërgimin në KZAZ të materialeve zgjedhore për çdo qendër votimi.

Në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, dispozitave si më poshtë referuar:

- neni 99, paragrafi 1, shkronja “a”, përcakton se “KQZ-ja dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve, materialet e mëposhtme zgjedhore, të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi”;
- neni 99, paragrafi 2 shkronja “a”, përcaktohen se “Përveç kutive me materialet zgjedhore, sipas pikës 1 të këtij neni, KZAZ-ve u jepen kuti votimi për çdo qendër votimi, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;
- neni 100, paragrafi 1, shkronja “a” dhe “b” përcakton se: “KZAZ-ja, jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit, u shpërndan materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj. Kryetari dhe sekretari i KQV-së, të shoqëruar nga çdo anëtar tjetër që kërkon, paraqiten në selinë e KZAZ-së dhe

Data: __ Dhjetor 2020

Nr: _____

Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore
që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021



tërheqin kutinë me materialet zgjedhore, sipas nenit 99 pika 1 të këtij Kodi dhe kutinë/kutitë e votimit;

d) neni 104, paragrafit 1, përcakton se “Në zgjedhjet për Kuvendin, në qendrën e votimit vendoset vetëm një kuti votimi.”

Në zgjedhjet pararendëse, që nga viti 2009 në vijim KQZ-ja ka përdorur kuti votimi me volum 83 litra dhe kuti të materialeve zgjedhore kutitë me volum 60 litra, të cilat kanë rezultuar të përshtatshme, me kapacitet të mjaftueshëm për fletët e votimit dhe për materialet zgjedhore, kanë qënë rezistente dhe nuk ka pasur problematikë gjatë transportit të tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administron në numër të mjaftueshëm të kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore, në gjendje fizike të pranueshme, të cilat mund të ripërdoren edhe në këtë proces zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19 paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafin 2, nenin 99 paragrafi 1, shkronja “a”, nenin 99 paragrafi 2, shkronja “a”, nenin 100, paragrafi 1 shkronja “a” dhe “b” dhe nenin 104 paragrafi 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S :

1. Të miratojë modelin dhe specifikimet teknike të kutive të votimit, që do të përdoren për në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1, pjesa I, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë modelin dhe specifikimet teknike të kutive të materialeve zgjedhore, që do të përdoren për në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1, pjesa II, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

LIDHJA 1



Modeli i Kutisë së Votimit:



Kapaciteti i kutisë së votimit: 83 litra (afërsisht me kapacitet për 1.000 flete votimi me përmasa A3)

Specifikimet:

- transparente,
- plastike,
- e sigurtë,
- e papaloshme,
- e riperdorshme
- kutia mbyllet me **4** kode metalike anësore dhe **1** kod metalik për pjesën e kapakut ku hidhen fletet e votimit.

Pjesa II

Modeli i Kutisë së Materialeve Zgjedhore:



Kapaciteti i kutisë së materialeve zgjedhore: 60 litra

Specifikimet:

- transparente,
- plastike,
- e sigurtë,
- e papaloshme,
- e riperdorshme
- kutia mbyllet me **4** kode metalike anësore.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
07.12.2020

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E MODELIT DHE SPECIFIKIMEVE TË KUTIVE TË VOTIMIT DHE KUTIVE TË MATERIALEVE ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021”

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “b” dhe “n”, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

Referuar nenit 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në KZAZ, kutive me materialet zgjedhore, dhe kuti votimi për çdo qendër votimi, në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor.

Në zgjedhjet pararendëse, që nga viti 2009 në vijim KQZ-ja ka përdorur kuti votimi me volum 83 litra dhe kuti të materialeve zgjedhore kutitë me volum 60 litra, të cilat kanë rezultuar të përshtatshme, me kapacitet të mjaftueshëm për fletët e votimit dhe për materialet zgjedhore, kanë qënë rezistente dhe nuk ka pasur problematikë gjatë transportit të tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administron në numër të mjaftueshëm të kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore, në gjendje fizike të pranueshme, të cilat mund të ripërdoren edhe në këtë proces zgjedhor.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përmes projektvendimit të paraqitur, propozon që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të miratojë përdorimin e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, të disponueshme nga KQZ, me model dhe specifikime teknike sipas lidhjes 1 bashkelidhur projektvendimit.

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm